



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.12/2018

Prishtinë, më 23.1.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari - Lila, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi, dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Memli Krasniqi, Dardan Molliqaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

I ftuara: Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Argjend Zejnaj, Eset Berisha dhe Ramë Qupeva - MI; Burim Ejupi dhe Dardan Abazi, INDEP; Agnesa Haxhiu, KDI; Etleva Malushaj GPP/ LVV, Agon Sinanaj, “Zëri” Sanie Jusufi, “Koha ditore”; Amire Qamili, “BIRN” dhe Blerta Bejtullahu, “Zyra e BE- së”.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e datës 16.1.2018;**
- 3.Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21 datë 22.12.2017, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë;**
- 4.Raportim i ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës, z.Pal Lekaj, në lidhje me pretendimet e “Bechtel -Enka”, për penalet që kanë derivuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në ndërtimin e Autostradës “Arben Xhaferi”;**
- 5.Miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 6.Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Sala Berisha-Shala, kryetare, propozoi që pikën 3 “Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21 datë 22.12.2017 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë”, ta kalojë si pikën 4, ndërsa, pika 4 të vendoset si pika 3 e rendit të ditës, pasi që tha e kemi të pranishëm ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës, z. Pal Lekaj dhe propozimi u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.1.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.1.2017, u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës, z.Pal Lekaj, në lidhje me pretendimet e Bechtel & Enka, për penalet që kanë derivuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në ndërtimin e Autostradës “Arben Xhaferi”;

Sala Berisha-Shala, kryetare :Komisioni në mbledhjen e kaluar ka marrë vendim për ta ftuar Ministrin e Infrastruktures z. Pal Lekaj, për shkak të disa pretendimeve rreth mospërmbushjes së detyrimeve ndaj Bechtel & Ekna, dhe e ftoj z. Lekaj, që të jep sqarime rreth këtyre pretendimeve.

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, tha se më kënaqësi kam ardhur sot që të raportojë rreth pretendimeve të Bechtel & Enka, dhe të ofrojë argumentet tona për këtë çështje. Me 2 korrik 2014, është nënshkruar kontrata në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Kompanisë Bechtel & Enka, për ndërtimin e Autostradës “Arben Xhaferi” traseja Prishtinë-Hani i Elezit, me afat të përfundimit të punimeve prej 42 (dyzetedy) muajve, pra deri me datën 20.1.2018. Pas vonesave të pagesave nga Qeveria e Kosovës për punët e kryera nga kontraktori, dhe rrjedhimisht ngecjes për përparimin e ndërtimit sipas planit dinamik, Qeveria e Kosovës është detyruar të kërkojë zgjatjen e afatit për përfundimin e punimeve. Kështu, më 30.9.2016, kryesuesi i Komitetit Ndërministror, ish- ministri Lutfi Zharku, kishte kërkuar nga Qeveria aprovimin e aneksit të kontratës për zgjatje të afatit për përfundimin e punimeve deri më 31.12.2018, me një kosto prej 14.778.654.78 euro, por Qeveria kishte kthyer prapa këtë kërkesë duke u arsyetuar se për këtë duhet të vendos vet Komiteti Ndërministror. Që nga ajo kohë e deri me datën 27.9.2017, kur është nënshkruar marrëveshja për zgjatjen e përfundimit të punimeve deri më 31.12.2018, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim. Marrëveshja për zgjatjen e afatit të kontratës është nënshkruar pa u definuar kostot financiare. Kjo kosto ishte diskutuar në mes të palëve, kontraktorit dhe Qeverisë, dhe ishte dakorduar të jetë në shumën prej 14.778.654.87 euro, por nuk ishte marrë vendim nga Komiteti Ndërministror. Në fund të muajit nëntor 2017, kontraktori kishte dorëzuar një dokument me të cilin janë pretenduar 63 milionë euro shpenzime në emër të zgjatjes së kontratës deri më 31.12.2018. Më 13.12.2017, Ministria e Infrastrukturës ka kërkuar nga mbikëqyrësi i kontratës “Hill International”, të hartojë një opinion lidhur me arsyeshmërinë e kërkesës së kontraktorit. Mbikëqyrësi i kontratës ka dorëzuar opinionin më të cilin është mbështetur kërkesa e kontraktorit për pagesë shtesë, sipas planit fillestar si me lartë por është refuzuar kërkesa për pagesa në pikën 2 dhe 3. Ministria e Infrastrukturës, pas marrjes së opinionit nga mbikëqyrësi i kontratës është takuar prapë me kontraktorin, dhe ka kërkuar që të arsyetohet

kërkesa e tij për pagesë të mjeteve për zgjatjen e kontratës deri në shumën e kërkuar. Përfaqësuesit e kontraktorit janë dakorduar që të diskutojnë në detaje secilin pretendim të tyre që bashkërisht me zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës, në mënyrë që të prezantohet një pasqyrë e saktë e shpenzimeve të kontraktorit. E drejta vendore e rregullon çështjen e kërkesës së kontraktorit me Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë rast, Qeveria e Kosovës, si kontraktore e punimeve e ka rolin e kreditorit, ndërsa kontraktori Bechtel & Enka e ka rolin e debitorit. Të dy palët kanë për detyrim përmbushjen e detyrimeve të tyre kontraktuale. Nëse njëra palë nuk i përmbush detyrimet e veta, atëherë pala tjetër ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe dëmshpërblimin. Qeveria e Kosovës ka hyrë në vonesë të pagesave ndaj debitorit në momentin që nuk i ka bërë pagesat sipas planit dinamik të pagesave. Si përfundim, kontrata për përfundimin e projektit të autorrugës Prishtinë – Hani i Elezit, ishte paraparë të përfundojë më 20.1.2018. Për shkak të vonesave në pagesën e shpenzimeve të ndërtimit nga ana e Qeverisë, kjo e fundit ka kërkuar zgjatjen e afatit të kontratës deri më 31.12.2018. Shpenzimet për këtë zgjatje të afatit nuk janë dakorduar. Kontraktori ka kërkuar 63 milionë euro, nga shuma e dakorduar më parë, prej rreth 14.8 milionë euro. Mbetet që Ministria e Infrastrukturës dhe kontraktori të definojnë saktë shpenzimet e kontraktorit për këtë periudhë, dhe të shmangen të gjitha pretendimet tjera të mundshme kontraktuale të kontraktorit ndaj Qeverisë, të cilat do të ishin jashtëzakonisht të pafavorshme. Ministri tha se çështjet që i diskutova, janë edhe në raportin më shkrim të dërguar për Komisionin javën e kaluar.

Mimoza Kusari – Lila: E falënderoj ministrin për raportin e detajuar, të cilin e ka dërguar edhe më shkrim. Megjithatë, konsideroj së është mirë të potencohet për opinionin publik që Komisioni Parlamentar ka kërkuar që ti ofrohet edhe kontrata, andaj, nuk i është përmbush kjo kërkesë komisionit. Kontrata për autostradën “Arben Xhaferi” e nënshkruar në korrik të vitit 2014, nga koha kur kemi pas një vakum institucional, dhe e kemi të pamundur të trajtojmë në detaje ose të konfirmojmë kredibilitetin e raportit të dorëzuar nga Ministria, në mungesë të kontratës. Po ashtu, e vlerësoj faktin që potencuat se e keni bërë publike shumën prej 63 milionë euro, *vetëm më lejoni ta ritheksoj se transparenca nuk është çështje e zgjedhjes individuale, por është detyrë institucionale dhe ato mjete janë mjete të buxhetit të Kosovës dhe për këto mjete, ju jo vetëm që e keni obligim institucional dhe personal por edhe obligim ligjor. Në mungesë të kontratës, ne duhet të bëjmë pyetje në bazë të hipotezave të raportit që ju e keni dorëzuar. Opinionit publik duhet t’ia bëjmë me dije edhe një fakt, në dhjetor të vitit 2015, ish- Qeveria ka paguar vlerë prej 8.404.167 euro si rrjedhojë e ndryshimit të pakos fiskale, gjegjësisht rritjes së TVSH-së nga 16% në 18%, kjo është e nënshkruar në kontratë në vitin 2014, por ne nuk e dimë, ne vetëm aludojmë. Ne si deputetë marrim vesh për pasojat, por nuk jemi në gjendje të tregojmë përderisa prapë po insistoj se kontrata duhet publikuar. Nuk është vetëm çështja se ne po ballafaqohemi me një problem të 63 milionëshit, kredibiliteti i 63 milionëshit është i barabartë me zero, kur nuk e ka bazën kontraktuale. E para faturat që janë dorëzuar dhe pagesat që janë bërë nga raporti i Ministrisë së Infrastrukturës, sipas shumës del që janë paguar 323.571.407 euro, rrjedhimisht nga ajo që është faktuar, borxh janë edhe 171.428.592 euro nga vetëm viti 2014 dhe viti 2016. Ministër, në raportin tuaj nuk ka asnjë informacion për vitin 2017, sa i përket pagesave, e dyta në buxhetin e Ministrisë tuaj për vitin 2018 keni paraparë nga buxheti i Kosovës pagesë për autostradën Prishtinë – Hani i Elezit, në shumë prej 66.000.900, kurse nga të hyrat e AKP-së 50.000.000, shuma totale për vitin 2018 rezulton 116.900.000, përderisa vetëm borxhi i evidentuar deri në fund të vitit 2016, sipas materialit tuaj rezulton për 171.000.000, dhe dallimi është 54.000.528 euro, do të thotë ne ende me pasqyrat financiare të vitit 2018, pa llogarit punët*

të cilat mund të kryhen ose janë kryer në vitin 2018. Ku po planifikoni ti merreni këto mjete? Si është planifikuar të diskutohet me Bechtel & Enka që Qeveria me buxhetin e vitit 2018, nuk ka mjete të përfundojë autostrada Prishtinë – Han i Elezit? Kërkoj urgjentisht nga ju si ministri që ta publikoni sa me parë kontratën që të dihen dëmet që ajo për të cilën po flasim ne është një ortek i borës, i cili sa po vjen e po rritet, nuk është kjo çështje politike e as individuale, por është çështje e rrezikimit të buxhetit të shtetit, kemi të bëjmë më një mbarëvajtje të sistemit shtetërorë që mund të kolapsojë nga obligimet që kemi marr nga një kontratë.

Hykmete Bajrami, çështja kryesore që u diskutua, është pikërisht kjo se ju keni bërë një zgjatje të afatit më 27.11.2017 dhe duhet ta shpjegoni se si keni nënshkruar si ministër pa u definuar kostoja, Çështje tjetër është së nënshkrimi i zgjatjes së afatit është dashur ti paraprijë një vendim i Komitetit Ndërministror, të cilët në fakt edhe janë përgjegjës të mbarëvajtjes së kontratës, as ketë nuk e kemi parë. Në buxhetin e Kosovës nuk ka mjaftueshëm mjete për ti kryer të gjitha obligimet kundrejt kontraktorit, a do të thotë kjo që edhe në fund të vitit 2018 prapë do të përballemi më një faturë tjetër shumë të madhe nga kontraktori Bechtel & Enka? Ajo që është pjesë e kontratës dhe është tepër me rëndësi për të gjithë kolegët këtu, por edhe për edhe gjithë popullin e Kosovës, është që në kontratë në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Bechtel & Enkës, në pjesën e ofertës janë 1 milion euro penalti për një muaj vonesë në pagesë, dhe kjo është ajo që Qeveria paraprake është pajtuar faktikisht me koston 14.78 milionë. Ne kur e shohim raportin është në frymën sikur ta kishte shkruar një punëtor i çmueshëm i Bechtel & Enkës, në faqen 5 të raportit, aty kur flitet për plotësimin e kushteve, ju nuk flisni për kushtet e kontratës të cilat e mbrojnë Qeverinë e Kosovës nga këto pretendime të pabaza, por keni shkruar që plotësohen të dy kushtet që Bechtel & Enka, ta fitojë lëndën në arbitrazh dhe kjo është komplet e papranueshme për Komisionin parlamentar. E keni cekur edhe ju në raport që mbikëqyrësi i kontratës, kompania “Hill International”, ka pranuar koston prej 16,6 milionë euro dhe në fakt këtë është mirë ta deshifroni se nga erdhën 16.6 milionë euro, kur dihet se në kontratë dhe sipas llogaritjeve janë vetëm 14.78 milionë euro, për pikën “b” dhe “c” është vet “Hill International” që thotë se nuk ka bazë ndaj pretendimeve të Bechtel & Enka, kurse ju hartoni dhe nënshkruani një raport se bashku me bashkëpunëtorët tuaj, ku thoni që janë plotësuar kushtet që kontraktori ta fitojë lëndën në arbitrazh. Unë nuk e di se kujt duhet ti besojmë, kompanisë “Hill International”, që është mbikëqyrës i projektit apo kujt? Te pika “b” është shuma prej 30.8 milionë euro, e cila thotë pajisjet që duhet të përdoren gjatë kësaj periudhe bazuar në përdorshmërinë e tyre me një kosto prej 8.38 milion euro, pasi kam qenë pjesë e Qeverisë së kaluar, dua t’ ju informojë së Bechtel & Enka nuk ka përdor pajisje, nuk ka situacione të papaguara në mandatin e kaluar, prandaj, pika “b” dhe “c” nga pretendimet e Bechtel & Enka bie komplet poshtë, dhe unë si deputete rekomandoj që ju rreth vetës të keni njerëz të cilët punojnë në interes së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe jo të tillë që siç e shoh ne raport punojnë më shumë për interesa të Bechtel & Enka.

Dardan Sejdiu: Kërkoj nga ministri që sa më parë që të jetë e mundur të bëhet publike kontrata e ndërtimit të autostradës. Nëse nga arka e shtetit dalin çdo vit nga 250 milionë euro dhe nuk e dimë ku shkojnë, ato e në fakt nuk i kemi ato, duket që po futemi në një situatë pa kthim, e cila në fund do të përfundojë me borxhe, e këto borxhe po na lënë një asfalt i cili nuk prodhon asgjë, por krijon kosto e në fund do t’ na detyrojnë që të vendosim laura për pagesa për shfrytëzim të këtyre asfalteve, ku qytetarët do ti paguajnë këto borxhe. Kërkoj që të na dërgohet edhe raporti i “Hill International” dhe ta kuptojmë saktë se pse “Hill International” thotë se 16.6 milionë kanë

kuptim, kurse pjesa tjetër janë pakuptim. Shtroj disa pyetje, e para, shuma prej 14.778.654.87 milionë euro, a do ishte e mundur që si deputet ta shohim kalkulimin se si është bërë për këtë shumë? Ne anën tjetër më intereson të dijë se çka do të ndodhte nëse kontraktori përfundon punimet dhe Qeveria ende nuk i ka kryer pagesat, a do të duhej të paguanim shtesë apo si është e rregulluar kjo me kontratë? Pastaj, këto pajisjet e Bechtel & Enkes, a për çdo kilometër rrugë i transporton? Kjo kompani në Kosovë është që një kohë të gjatë dhe këto pajisje nuk është që po vijnë nga një territor tjetër. A ka ndodh që nga raportet e “Hill International” të kemi situatë kur si mbikëqyrës të këtij projekti, kjo kompani në ndonjë nga raportet e saja të thotë që Bechtel & Enka nuk duhet të marrë më asnjë cent shtesë apo çdoherë një pikë ua aprovon e disa të tjera nuk i aprovon? Ministër, është shumë e rëndësishme të ceket se raporti i mbikëqyrësit të kontratës thekson se nga 3, pikat pretenduese të kompanisë Bechtel & Enka, 2 prej tyre i ka cilësuar si të pabaza, kurse në raportin tuaj i jepni të drejtë në të 3 pikat për këto pretendime kompanisë. Dhe, e fundit a është duke ndodhur ndonjë takim për zarfin në mes te kompanisë Bechtel & Enka dhe Ministrisë se Infrastrukturës, për këto pretendime të kësaj kompanie dhe sa milionë do na kushtojë negocimi i këtij rasti të ri?

Bilall Sherifi: Më intereson, cili është pozicioni i juaj në gjithë këtë çështje dhe çfarë qëndrime do të mbajë kjo Qeveri, rreth këtyre pretendimeve?

Gani Dreshaj: Ministër, kërkoj nga ju që këtë punë ta çoni deri në fund, dhe shuma prej 1 milion euro në muaj, është shumë. Po mendoj që kjo kontratë duhet të ndërpritet, pasi shumë nga çështjet tjera u përmenden nga kolegët, nuk po zgjatem më shumë.

Sala Berisha-Shala, kryetare, tha se edhe për mua është shumë më rëndësi ky diskutim, por ajo që më shumë bie ne sy ose vërehet, është fenomeni se ne prezence te mediave, diskutimet e deputeteve me shume po marrin kahje populiste. Unë jam deputete në mandatin e pestë dhe nga pervoja ime ne kete pozicion kam pa keto raste, kur deputetët kane qene pjese e ekzekutivit apo kanë qenë pjesë e Qeverisë dhe varësisht nga keto pozicioni ligjevens apo ekzekutiv, i ndryshojnë edhe qëndrimet e tyre ndaj qeshtjeve apo temave të caktuara. Megjithate, e konsideroj që është fat që në këtë Komision kemi në përbërje 3 ish- ministra dhe besoj që kjo do të na ndihmojë ti shohim çështjet objektivisht nga të dyja këndvështrimet. Diskutimet në frymën e asaj që asfalti nuk prodhon asgjë; jam e bindur që edhe ata që e thonë; e dinë se nuk është ashtu. Infrastruktura rrugore është një prej elementeve më të rëndësishme për zhvillimin e një vendi. Kosova ka nevojë për investitorë të jashtëm, kështuqë mbas infrastrukturës ligjore, element i rëndësishem per investitorë të mundshëm, per nje ambient biznesor, është infrastruktura rrugore. Mandej, kjo qasja e krijimit të dy taborëve në mbrojtje të Qeverisë apo kontraktorit, mendoj që nuk është qasje e duhur sepse nuk është lajm i mirë për tërheqje të investitorëve. Natyrisht që Qeveria dhe kontraktuesit diskutojnë çështjet dhe krijojnë marrëveshje. Sigurisht që edhe unë jam shumë e interesuar të shoh këto kontrata dhe kah po shkon dhe si po shpenzohet çdo cent i taksapaguesve të këtij vendi.

Hykmete Bajrami: Kryetare ne të respektojmë si kryetare e këtij Komisioni, por besoj do të ishte edhe në favor të Komisionit edhe të përfaqësuesve të Qeverisë dhe të gjithë të tjerëve, që ju më shumë të merreni me palët që i kemi ftuar në raportim se sa me neve. Ndërkohë, nuk po ndërrojmë qëndrime, dhe nëse mendoni se mediat ju pengojnë, ju jeni kryetare e komisionit dhe mund ti

largoni, por mendoj se këtë po e bëjmë për hir te transparencës dhe nuk janë gjëra që duhet të fshehën.

Sala Berisha-Shala, kryetare: Unë, edhe ashtu siq po e shihni, jam në mes të tavolinës, dhe fjalën që e thash ashtu e hodha në mes, ndërsa kujt t'i duket që është e tij, le ta merr. Sa i përket asaj, pse unë nuk e pyeta ministrin, janë çështje për të cilat edhe unë kam interesim, por shumica nga to u ngritën nga ju kolegë deputetë dhe nuk është e nevojshme që të përsëriten të njëjtat gjëra. Sa i përket, asaj që; a me pengojnë mua mediat, e them me bindje se anjehere nuk me pengojne, përkundrazi, mediat janë shumë të mirëseardhura. Kete e kam theksu cdo here, e edhe ne fillim te vitit, në mbledhjen e parë të këtij komisioni ku edhe i kam falënderuar publikisht për hapësirën që na kanë dhënë dhe vazhdojne me i dhene rendesi dhe hapësire punes se komisionit. Unë i kam qëndrimet e mia të njëjta jane apo nuk janë prezente mediat, për dallim qe prej disave këtu që nuk janë të tillë dhe prezenca e mediave ua ndryshon qasjen.

Dardan Sejdiu: Për hir të opinionit, e para në asnjë deklaram timin publik kryesuese nuk kam folur kundër infrastrukturës dhe kundër ndërtimit të autostradës, por kam fol për koston, barrën buxhetore për ndërtimin e një autostrade, për të cilën nuk e kemi idenë se sa kushton apo për të cilën marrim informacione sporadike. Sa për informacion tuajin kryetare, çdo kontratë shtetërore në një republike parlamentare duhet të shpërfaqet para atyre që janë përfaqësues të popullit, e që e mbrojnë kuletën e qytetarit më anë të buxhetit, qoftë leximit të kontratave që nënshkruan një Qeveri dhe kështu i mbajmë përgjegjëse qeveritë për veprimet e tyre.

Mimoza Kusari – Lila: Bashkëpartiake i ministrit, deputeti Dreshaj kërkoi që t'ia lidh kryet kësaj pune disi, e unë i them që kryet i lidhet këtu në komision. Për informatë, janë 5 ministra të Komitetit Ndërmnistrorë dhe nëse buxheti i Kosovës për vitin 2018, parashikimet që i ka janë mangu për diku 54 milionë për pune të kryera deri më tash, duhet që ne si temë shumë serioze ta diskutojmë, se cila është e ardhmja e kësaj kontrate. T'a theksojmë se e njëjta kompani ka pasur kontratë në Rumani dhe në Kroaci, dhe të dyja janë shkëputur në dakordim me kompaninë, nëse penalltitë me miliona, të cilat vijnë në fatura për tu paguar nga buxheti i shtetit, nuk mund të paguhen, atëherë duhet të rikonsiderohen. Ne si komision kemi kërkuar që të na dorëzohen kopjet e raporteve për punët e kryera si dhe kontrata.

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës: Kontratën nuk e kam sjell sepse kjo kontratë ka obligime, dhe kjo kontratë parasheh me klauzolën 1.9 që të trajtohet si kontratë konfidenciale, përveç nevojës për ti zbatuar ligjet në fuqi. Unë nuk jam i thirrur si ministër që të shkel detyrimet që dalin nga kjo kontratë. Edhe për mua është e çuditshme se si parashihet që kjo kontrate të trajtohet si konfidenciale, dhe unë mund ta publikoj vetëm me vendim të Gjykatës Themelore, e jo ndryshe. Unë mund të them që sikur të isha ministër, nuk do ta nënshkruaja një kontrate të tillë. Sa i përket asaj që nuk është cekur në pasqyrat financiare se sa janë paguar në vitin 2017, janë paguar 181 milionë euro dhe mund të them që gati sa është kryer punë për 3 vite bashkë, është kryer pune vetëm këtë 4 mujor, me shpronësime dhe me shlyerje të obligimeve, e këtë e kam shënuar edhe në raport. Po i përgjigjem ish- ministres dhe anëtares së Komitetit Ndërmnistrorë dhe mua me çudit fakti nëse jeni pajtuar me shumën prej 14.7 milionë euro, kur e keni pas kontratën ish- ministri dhe Komiteti Ndërmnistrorë, që e ka analizuar në mënyrë analitike për kryerje të obligimeve me planin e veprimit të Bechtel & Enka. Ju lutem, pse keni kërkuar shtyrje të kontratës njëvjeçare që t'i paguajmë nga 1 milion euro në muaj? Më 30.9.2016,

vendim mbi aneksin e kontratës, me të cilin ish- ministri ka kërkuar nga Qeveria që kjo kontratë të vazhdohet me koston rreth 14.7 milionë euro, dhe Qeveria e Kosovës e ka shqyrtuar dhe u ka kthyer përgjigjen ku thotë se: Komiteti Ndërmnistrorë është kompetent për këto vendime dhe Qeveria nuk ndërhyt në këtë çështje. Dhe asnjëherë nuk është nënshkruar kjo aneks kontrate dhe tani për këtë mosveprim janë të gjitha këto probleme që tani ne duhet ti zgjidhim. Keni qenë anëtare e këtij Komiteti dhe nuk keni marr vendim, me thoni tani se ku mbetet faji dhe si do të jetë zgjidhja? Sa i përket nënshkrimit të marrëveshjes së kontratës pa kosto, e kemi nënshkruar për shkak të një letre nga Bechtel & Enka, ku thuhet që nëse nuk nënshkruhet do të ndërpritet puna dhe do të shkohet në arbitrazh, që po ju them që afro 200-300 milionë do ti kushtonte buxhetit të Kosovës. U përmend rasti i Rumanisë dhe i Kroacisë me Bechtel & Enka, pa u përfunduar asnjë punë i ka kushtuar buxhetit te Kroacisë diku rreth 87 milionë euro për shkaputje të kontratës, dhe nëse kemi atë luks le të vendos Parlamenti dhe Komiteti Ndërmnistrorë, çfarëdo vendimi që bien do të jem i gatshëm ta zbatojë. Sa i përket raportit, i cili përfshin pretendimet e Bechtel & Enka për vitin 2014, 2015 dhe 2016 dhe jo për vitin 2017 sepse për këtë vit janë paguar 181 milionë euro, u përmendën raportet e punëve të kryera se pse nuk i kemi sjellë, aty ka raporte të punëve të kryera në një volum shumë të madh dhe problem do të jetë më i lexua, por nëse kërkohet do t'ua sjellim. Unë do të bëjë përpjekje që nëse pajtohet pala të sjellim kontratën, por nëse pala nuk pajtohet nuk do të bëjë shkelje të kontratës. Sa i përket asaj se çfarë qëndrimi do të mbajë, të jeni të sigurt se nuk do të pajtohem me 63 milionëshin dhe në bazë të kontratës do të dakordohemi, për këtë të jeni të sigurt. Tani po pyes ish- ministren Bajrami, pse pas atyre 100 takimeve dhe pas shkëmbimit të gjithë atyre letrave pse nuk keni marr një vendim dhe mos të vimë deri këtu?

Hykmete Bajrami: E para, fillimisht unë kam qenë anëtare e Komitetit Ndërmnistrorë dhe si të tillë asnjëherë nuk jemi takuar me përfaqësuesit e Bechtel & Enka. Është e vërtetë që fillimisht ish- ministri e ka dërguar në Qeveri këtë çështje dhe Qeveria ka thënë se nuk është përgjegjëse. Komiteti Ndërmnistrorë dhe ish- ministri është këshilluar që të presim rishikimin e buxhetit të vitit 2017 dhe ju e dini që Qeveria ka ra në muajin maj, nuk kemi arritur të bëjmë rishikim të buxhetit. Qëllimi i Komitetit Ndërmnistrorë ka qenë që të shlyhen një pjesë e obligimeve, në mënyrë që të mos bëhen pjesë e aneksit të kontratës. Argument i fortë i Ministrisë tuaj, pavarësisht se ku do të përballeni mund të përdoret që Bechtel & Enka ka punuar në bazë të planifikimit të pagesave sipas situacioneve dhe për çdo punë të kryer janë realizuar pagesat. Tani ju na treguat për nënshkrimin aneks kontratën pa kosto, kjo gjë i jep forcë Bechtel & Enka sepse tani mund të kërkojë një kosto financiare, pasi veç është nënshkruar aneks kontrata dhe pse keni nënshkruar pa vendim të Komitetit Ndërmnistrorë?

Sala Berisha-Shala, kryetare: Ministri e përmendi, që po të ishte ministër në atë kohë nuk do të nënshkruante një kontratë të tillë. Unë i them se tani z. Minister e keni mundësinë e përmirësimeve, qoftë përmes aneks kontratave, qoftë përmes marrëveshjeve të ndryshme. Shtroj pyetjen „A ka mundësi që aneks kontratat të nënshkruhen pa u mbledhur Komiteti Ndërmnistrorë?“

Mimoza Kusari – Lila: Arsyeja e ftesës tuaj z. ministër është evitimi i deklarimeve politike dhe përplasjeve që po ndodhin në Parlamentin e Kosovës pa bazë të shkruar, e me këtë ritëm vazhduat edhe ju duke thënë se në këtë 4 mujor është punuar më shumë se sa 3 vite të tjera së bashku. Pse nuk është pjesë e raportit tuaj edhe viti 2017? Ajo çka neve na intereson është ta dimë procesin e

mirëfilltë. Është edhe çështja e rishikimit të buxhetit të viti 2017, i cili është aprovuar me minus 200 milionë euro për arsye të moskalimit të Ligjit të AKP-së, dhe nuk është kthyer fondi i AKP-së. Tash në vitin 2018, prape janë 50 milionë për të njëjtin projekt prej fondit të privatizimit, ende ligji nuk është miratuar dhe çka nëse ndodh sikur herën e kaluar, bie Qeveria e nuk miratohet ligji, prapë penallti?

Dardan Sejdiu: A ka pasur opinione të tjera nga “Hill Internatinal” përveç këtij në të cilin është bërë pagesa shtesë për shkak të opinionit të tyre për Bechtel & Enka? A është duke ndodhur tani ndonjë diskutim për zarfin e ri me përfaqësues të Bechtel & Enka? Po ju citoj: “Une çuditem që është nënshkruar kjo kontratë, unë nuk e kam nënshkruar, është shkelje nëse publikohet, sikur të kisha qenë ministër nuk do ta nënshkruaja, por mua me obligon kontrata mos ta publikojë sepse është shkelje”, pyetje për ju, a mendoni që është e nevojshme të ngritet hetim për këtë kontratë? Dhe e fundit a mund të publikohet neni 1.9 i kësaj kontrate?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës: Sa i përket diskutimit rreth zarfit të ri, po dhe të jeni të bindur që do bëjmë maksimumin që të mos dëmtohet buxheti i Qeverisë së Kosovës. Sa i përket asaj që a ka pas opinione nga ana e mbikëqyrësit, nuk është kërkuar asnjëherë, unë nuk kam gjetur ndonjë analizë apo raport të “Hill International” apo ndonjë kërkesë që është parashtruar nga ish- ministri apo ish- Komiteti Ndërmintorë, që të behet një hulumtim, edhe për atë shumën që këta kanë kërkuar në bazë të kontratës. Për hetime janë organet kompetente, unë nuk mund ti ndalojë dhe në çdo kohë mund të veprojnë. Ne shkurt të vitit 2017 është dërguar një shkresë për Komitetin Ndërmintorë nga Bechtel & Enka më të cilën është specifikuar komplet kërkesa e tyre, e cila është e protokolluar e gjitha që u është drejtuar juve dhe ish-ministrit. Sa i përket asaj që e përmendët se nuk ua kam dërguar pasqyrat, i keni pasqyrat saktësisht se sa janë paguar dhe ato që i kemi kryer obligimet tona, ne i kemi paraparë dhe punët do të kryhen me 31 dhjetor të vitit 2018, dhe mund të jetë pagesa e fundit në vazhdim të vitit fiskal të vitit 2019, dhe kjo do të hyjë në klauzolë të kontratës për kosto. Jam këmbëngulës që kontrata të zbatohet dhe të kryhen obligimet e dala nga kontrata nga të dyja palët.

Dardan Sejdiu: Ju thatë se po mos ta kisha nënshkruar dokumentin e fundit pasoja do të ishte arbitrazhi dhe do të humbnim qindra miliona euro, a mund të dokumentohet ky konstatim i juaji?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës: Unë e thash që kontrata fillestare ka qenë për 42 muaj dhe Qeveria e Kosovës është dashur të lexojë kontratën dhe ta saktësojë dhe me miratimin e buxhetit të shtetit, të bazohet në punë që është zotuar Bechtel & Enka. Kjo nuk është bërë dhe mu për këtë ka ardhur deri te kjo. Duhet ta them qartë së Qeveria e Kosovës nuk i ka kryer obligimet, dhe neve na është dërguar shkresa e fundit, nëse nuk e nënshkruani këtë aneks kontrate, jemi të detyruar që çështjen e kontratës ta dërgojmë në arbitrazh, dhe pas takimit me Bechtel & Eknka, që ditën e parë kur kam parë vështirësitë i kam lutur që të mos vije deri te kjo gjendje sepse nuk do të preferoja asnjë Qeveri të përballet me një situatë të tillë.

Gani Dreshaj: Mua nuk po me pëlqen aspak kjo e drejta që ministri paska të drejtë me nënshkrua pa e ditur ne fare. Ministër, të kërkojë të mos hyni në penallti sepse edhe pse je nga partia ime nuk do të lëshojë pe.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të ftojë ministrin e Infrastrukturës që të raportojë për secilën çështje në interes të Komisionit, dhe i njëjti do të ofrojë Komisionit raportet dhe materialet që i kërkohen.

4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21 datë 22.12.2017 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Sala Berisha-Shala, kryetare: Kjo pikë ishte edhe në mbledhjen kaluar por e hoqëm nga rendi i ditës për shkak të marrjes më vonës të materialit. Andaj, siç e dini Bordi i ZRRE-së ende nuk është i kompletuar dhe ju kisha ftuar ta miratojmë këtë propozim, sepse ZRRE-ja s'ka bord nga prilli i vitit të kaluar. Po ashtu, nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë na kanë bërë thirrje që sa më shpejt ta kemi këtë bord. Nderkohe që edhe ZRRE-ja duhet të vendos për tarifat e reja të energjisë elektrike. Për lehtësim të punës e kemi edhe një Memo të përgatitur nga stafi i Komisionit, ku është konstatuar se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet formale sipas ligjit.

Dardan Sejdiu: Kemi pranuar një aneks të një kandidati i cili pretendon së i është bërë e padrejtë gjatë seleksionimit nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik, dhe i cili ka bërë ankesë në Qeveri, dhe ende nuk ka marrë përgjigje. Andaj, propozoj që të mos procedohet më tutje Vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, derisa të përfundojnë procedurat e ankesës për të drejtën e kandidatit.

Duda Balje: Nuk do ta mbështes këtë Propozim -Vendim të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, sepse nuk është i përfshirë asnjë kandidatë nga komunitetet e tjera që duhet ta ketë përfaqësuesin e vet dhe në këtë institucion –ZRRE.

Mimoza Kusari-Lila: Propozoj që ti kthehet prapa Qeverisë ky vendim, derisa nuk janë përfunduar të gjitha procedurat ankesave të kandidateve. Po ashtu, kërkoj që Qeveria të sqarojë pse ende nuk ju është kthyer përgjigja kandidatit, i cili ka bërë ankesë.

Hykmete Bajrami, tha se pajtohet me propozimin e znj.Kusari-Lila, së duhet pritur të përfundojë koha e shqyrtimit të ankesave të kandidatëve që kanë aplikuar për këtë Bord.

Kryetarja, sqaroi se Komisioni nuk ka mandat të bëjë seleksionimin e kandidatëve konkurrues për emërimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së, dhe në bazë të dispozitave të Ligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, që ndërlidhen me kushtet që duhet t'i plotësojë anëtari i bordit, është neni 6, paragrafi 1 dhe 2 dhe në bazë të aplikacioneve këta kandidatë të propozuar nga Qeveria i plotësojnë kushtet ligjore, andaj, kërkoj që të procedojmë në Kuvend për miratim në seancë plenare këtë vendim, sepse tash një vit Bordi mbetet i pakompletuar dhe kemi mungesë të marrjes së shumë vendimeve që ndërlidhen me punën e ZRRE-së por edhe të furnizimit më energji.

Bilall Sherifi, kërkoi të informohet nga Qeveria, së ka a pas detyrim Qeveria të presë afatin e përfundimit të ankesave dhe t'iu kthehet përgjigje kandidatëve. Kjo çështje duhet të sqarohet, pastaj Komisioni e ka më të lehtë shqyrtimin e kësaj liste të kandidatëve..

Pas debatit, më 2 (dy) vota për, 4 (katër) kundër dhe 2 (dy) abstenim, Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Vendimi i Qeverisë nr.17/21 datë 22.12.2017, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, të mos procedohet tutje, derisa Qeveria të dërgoj raport shtesë, më të cilin raport e njofton Komisionin për procedurën e të drejtën e ankesës së kandidatit.

5. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2018;

Kryetarja, tha se ky Plan i punës ishte për diskutim edhe në mbledhjen e kaluar, por u pajtuam që të formohet një grup i punës dhe t'i pranojmë propozimet më shkrim të anëtarëve të tjerë të komisionit. Grupi i punës është mbledhur dhe së bashku më stafin e komisionit janë të përfshirë të gjitha propozimet. Ajo theksoi se në këtë Plan po mbetet të vazhdojë punën vetëm një grupi, që është duke bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Energjinë Elektrike, që ka mbetur nga viti i kaluar, të bartet për vitin 2018, ndërsa, në pjesën e dytë të vitit të vendoset kur do të rishikohet plani i punës.

Pas propozimeve, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plan i punës së Komisionit për vitin 2018.

6. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

a) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Hykmete Bajrami, propozoi që lidhur më mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, të bëhet një formë tjetër e modelit të mbikëqyrjes, sepse vetëm duke i vizituar institucionet e duke i pyetur nuk më duket se është ndonjë metodë e mirë. Kërkoj që për këtë, fjala vjen të bëjnë ndonjë propozim organizatat që e mbështesin komisionin.

Dardan Abazi, OJQ INDEP: Falënderoj Komisionin për mundësinë dhe bashkëpunimin, dhe premtoj se do ta mbështes komisionin në këtë drejtim, duke ofruar një manual se si do të bëhej mbikëqyrja e zbatimit të ligjit.

Propozimi i deputetes u përkrah nga Komisioni.

b) Projektligji për shoqëritë tregtare

Hykmete Bajrami, në lidhje me raportin me amendamente të Projektligjit për Shoqëritë Tregtare, propozoi që grupi i punës të takohet edhe njëherë, para së të shqyrtohen amendamentet

në Komision, për ti rishikuar edhe një herë amendamentet ngase kam marrë disa propozime nga palë të ndryshme, e kemi edhe një hulumtim të pavarur, kështu që nuk duhet të ngutemi sepse disa çështje duhet ti specifikojmë më mirë.

Propozimi i deputetes u përkrah nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

**E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA